



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PREFEKTI I QARKUT DURRES

# PREFEKTI I QARKUT DURRËS

## ANALIZA VJETORE 2020

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më 03.02.2021

# PëRMBAJTJA

- ❑ MARRëDHëNIET E PREFEKTIT Të QARKUT ME ADMINISTRATëN QëNDRORE
- ❑ MARRëDHëNIA E PREFEKTIT Të QARKUT ME ORGANET E VETëQEVERISJES VENDORE
- ❑ ARSIMI
- ❑ DREJTIMI I TASK-FORCAVE, KOMITETEVE PëR ÇëSHTJE Të CAKTUARA
- ❑ SEZONI TURISTIK, RISITë, REZULTATET
- ❑ EMERGJENCAT CIVILE
- ❑ PERIUDHA PASTëRMET
- ❑ LUFTA KUNDëR COVID-19.
- ❑ VERIFIKIMI I LIGJSHMëRISë Së AKTEVE Të ORGANEVE Të VETëQEVERISJES VENDORE
- ❑ DETYRAT DHE PRIORITETET PëR VITIN 2021

# MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Veprimtaria një vjeçare dhe e përditshme e Institucionit të Prefektit ka konsistuar në realizimin e objektivave, implementimin dhe zbatimin e prioriteteve dhe politikave të Qeverisë. Ka konsistuar në ndërtimin e një marrëdhënie të b/p reciprok si në marrëdhëniet qendrore në nivel vendor ashtu dhe me organet e vetqeverisjes vendore, duke bashkërenduar gjithashtu veprimtaritë e tyre, me qëllim realizimin e objektivave qeverisë në ruajtjen e rendit dhe sigurinë, ofrimin e shërbimeve arsimore dhe shëndetsore cilësore si dhe monitorimin e çdo lloj veprimtarie ligjore të institucioneve në qark.



# MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

Institucioni i Prefektit për këtë vit të vështirë ka qënë maksimalisht i angazhuar për periudhën pastërmet, në luftën kundër COVID-19, antikanabisin, sezoni turistik veror, arsimin etj, duke luajtur një rol kryesor në menaxhimin e këtij viti të vështirë dhe koordinimin e veprimeve me anë të mekanizmave ligjore dhe Task-Forcat të krijuar në këtë kuadër.

Institucioni i Prefektit u përball me fluksin e personave të pastreh të banorëve të dëmtuar nga termeti, në operacionin e akomodimit, strehimit të banorëve të dëmtuar, në operacionin e vlerësimit të dëmeve, të operacioneve të ndarjes dhe vendosjes së çadrave si dhe të ndarjes së ndihmave. Gjithashtu ka ndjekur në vijmësi të gjitha zbatimet e këshillave bashkiakë në zbatim të vendimeve të Qeverisë për rindërtimin deri në përrurimin e shkollave dhe banesave individuale.

Në luftën kundër COVID-19, sipas të gjitha etapave ka mundësuar zbatimin e Vendimeve të qeverisë në terren për zbatimin e protokolleve të MSH.etj.

Kështu mund të përmëndim:



# MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

## **Administrata e Prefektit të Qarkut Durrës ka:**

- Zbatuar Urdhërat dhe Udhëzimet e ardhura nga autoritetet qendrore.
- Koordinuar punët dhe bashkërenduar veprimtarinë me Degët Territoriale që veprojnë në Qark.
- Koordinuar veprimtarinë ndërmjet vetë Degëve Territoriale si dhe të këtyre me Organet e Vetëqeverisjes Vendore.
- Dërguar informacione, raporte periodike në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e Degëve Territoriale, sipas Urdhërit të Kryeministrit, dhe për probleme të veçanta, sipas Urdhërit të Ministrit.
- Dërguar informacione, raporte mujore në Ministrinë e Brendshme sipas Urdhërit të Ministrit të Brendshëm dhe për probleme të veçanta.
- Parandalimi dhe menaxhimi i emergjencave, lufta kundër COVID-19, kanabisit etj.

# MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

- ▶ Më datën 31.01.2020 në Institucionin e Prefektit u zhvillua takimi me ambasadorin amerikane Znj. Yuri Kim për tërmetin e datës 26 Nëntor 2019.
- ▶ Ambasadores ju prezantua një briefing për masat e marra, punën e bërë dhe problematikat si dhe u njoh me punën e shtabit të EC për periudhën pastërmet. Në takim morën pjesë znj. R Voda si kryetare e shtabit të emergjencave të qarkut të Durrësit, z. H Çako drejtor i AKMC dhe z. R Nasto Prefekti i Qarkut.

Në fjalën e saj Ambasadorja falenderoi për punën e bërë deri tani si dhe siguroi ndihmën që do të japin SHBA si dhe dha disa mendime për vazhdimin e punës deri në ringritje.



# INFRASTRUKTURA RRUGORE

## Në fushën e Infrastrukturës Rrugore

Gjatë vitit 2020 Institucioni i Prefektit e ka përqëndruar vëmendjen e punës dhe në drejtim të infrastrukturës dhe në mënyrë specifike në drejtim të asaj rrugore dhe sigurisë së saj. Janë zhvilluar takime të ndryshme me të gjithë strukturat përgjegjëse si dhe janë ndjekur shumë problematika të tilla edhe me praktika shkresore.



# INFRASTRUKTURA RRUGORE

## Ndër takimet dhe vemrimentaritet kryesore në këtë drejtim përmendim:

- ▶ **Më datë 21.02.2020** dhe më datë **03.07.2020** nga Prefekti u zhvillua një takim për masat paraprake që duhet të merren në drejtim të sigurisë rrugore në tërësi. Në këtë takim ishin të pranishëm z. Erion Koka Drejtori i Rajonit Qëndror pranë ARRSH-së për qarkun Durrës, N/Drejtori i Policisë së Qarkut Durrës, Shefi i Policisë së Qarkullimit Rrugor për qarkun Durrës, Drejtori i Ndërmarrjes Rrugë pranë Bashkisë Durrës, N/Bashkisë Durrës dhe specialistë të bashkisë për sinjalistikën rrugore, N/Kryetari i Bashkisë Shijak, Drejtori i Policisë Bashkiake Bashkia Krujë. Në takim u bë një panoramë e situatës së rrugëve urbane dhe nacionale në Qarkun Durrës, nisur edhe nga problematikat e një viti më parë të parashtuara si dhe u lanë detyra konkrete për çdo strukturë përgjegjëse.

## **Në takim theksi u vu në këto drejtime:**

- ▶ **sigurisë rrugore në tërësi,**
- ▶ **infrastrukturës rrugore,**
- ▶ **mjetet rrugore,**
- ▶ **përdoruesit e rrugës.**





# INFRASTRUKTURA RRUGORE

- ▶ Këto elementë në përgjithësi si gjatë vitit dhe gjatë sezonit turistik veror u siguruan nëpërmjet një bashëpunimi dhe kordinimi të punës nëpërmjet strukturave të pushtetit qëndror me atë vendor dhe institucionet përgjegjëse. Në fillim të vitit u hartua plani i punës i përbashkët si dhe operacionet e ndërveprimit sipas problematikave të shfaqura në mënyrë që ti zgjidhnin ato në kohë dhe në mënyrë sa më optimale.
- ▶ Identifikimi dhe marrja e masave shërbeu edhe për parapregatitjen për sezonin e ri turistik, gjë për të cilën nga Prefekti në takimin e dytë u lanë disa detyra në lidhje me vazhdimin e investimeve në sinjalistikë në mënyrë të veçantë për bashkinë Durrës, kjo në kuadër të sezonit të ri turistik.



# INFRASTRUKTURA RRUGORE


Gjithashtu detyrat konkrete të lëna për Drejtorinë e Rajonit Qëndror pranë ARRSH-së për qarkun Durrës në lidhje me ndërhyrjet në akset rrugore të cilat paraqesin problematika specifike si dhe në mirëmbajtjen e tyre u realizuan me sukses në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit.

Lidhur me Policinë e Shtetit nga Prefekti është kërkuar vazhdimisht raporte dhe informacione të hollësishme lidhur me problematikat që ata kanë konstatuar dhe në bashkëpunim me institucionet vendore dhe qendrore është bërë e mundur zgjidhja e tyre. Bashkëpunimi ka qenë në nivele optimale.



# INFRASTRUKTURA RRUGORE

- Prioritet i punës tonë për 2021 në drejtim të sigurisë rrugore do të jetë padyshim angazhimi ynë maksimal në ndjekjen e çdo problematike që do të dal si dhe koordinimin dhe bashkërendimin i punës me të gjithë strukturat përgjegjëse për një siguri maksimale në rrugët rurale dhe nacionale që përfshihen në qarkun tonë



# MJEDISI

## Në drejtim të mbrojtjes së mjedisit

Institucioni i Prefektit ka ndjekur, monitoruar dhe ka bashkëpunuar me të gjithë strukturat përgjegjëse në nivel qarku në drejtim të ndjekjes së çështjeve, nismave dhe aksioneve të ndryshme në mbrojtje të mjedisit si.psh.:

Gjatë gjithë vitit 2020 vëmendja është përqendruar në evadimin e plehrave nga qyteti i Durrësit dhe Njësitë Administrative drejtë Tiranës, pasi vendgrumbullimi i Durrësit u mbyll. Në bashkëpunim me bashkinë Durrës, janë bërë kërkesat e vazhdueshme pranë zyrës së Kryeministrit për çeljen e fondeve shtesë për këtë qëllim.



# MJEDISI

Në prag të hapjes së sezonit turistik më datën 18.06.2020 u ndërmor aksioni i pastrimit në vijën bregdetare të Gjirit të Lalëzit. U angazhuan 150 forca dhe 17 mjete. U pastruan 4 km vijë bregdetare.

- ▶ Ndërmarrjet dhe institucionet që morën pjesë ishin:
- ▶ Prefektura Qarkut Durrës, Bashkia Durrës, Ndërmarrja “Rruga”, Ndërmarrja Komunale Plazh, NSHK, UKD, APD, OSHE, Zonat e Mrojtura, Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit dhe Hekurudha.
- ▶ **Më datë 24.06.2020** është zhvilluar  **dita e pastrimit në derdhjen e Lumit Erzen** në bashkëpunim me punonjësit e zonave të mbrojtura dhe studentët e degës mjedis të Universitetit “Aleksandër Moisiu”.
- ▶ Në të tre bashkitë e Qarkut Durrës në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit gjatë gjithë vititi, por në veçanti gjatë sezonit veror është bërë e mundur nëpërmjet aksioneve të pastrimit, të mbahet pastër të gjitha mjediset e qyteteve dhe zonave turistike, por ky problem madhor mbetet si detyrë e vazhdueshme për të gjithë ne për të mbajtur sa më pastër ambientin.



# ANKESAT

Gjatë vitit 2020 është ndjekur dhe monitoruar çështja e ndotjes akustike. Institucioni i Prefektit ka trajtuar disa ankesa të banorëve kryesisht të zonave pranë subjekteve lokale që ushtrojnë muzikë gjatë fundjavave, gjë për të cilën kemi kërkuar inspektime dhe verifikime nga strukturat përkatëse. Edhe pse ka patur inspektime të ndryshme me grupe pune të Policisë së Shtetit, ISHMPUT, problem mbetet çështja e aparatit për matjen e nivelit të zhurmave. Nga Nj.V.K.Shëndetësor raportohet që kjo aparaturë nuk është në gjendje funksionale (i kalibruar), çka krijojnë probleme në përcaktimin e saktë dhe marrjen e masave administrative për subjektet abuzuese që shkaktojnë ndotje akustike.

**Më datë 13.02.2020** është ndjekur problematika e vazhdueshme që kishin banorët e lagjes nr. 4 (pas qëndër tregëtare Blu Star) **në lidhje me zhurmat akustike**, që shkaktohen. Për këtë u zhvillua një takim me përfaqësues të Njësisë Vendore të Shëndetit Publik, përfaqësues të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Inspektoriatit të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, ku u kërkuua marrja e masave konkrete për zgjidhjen e kësaj situatë. Pas takimit një grup pune me përfaqësues të institucioneve të mësipërme, shkoi në vend në Qendrën tregëtare Blu Star, ku mori kontakt me menaxherët e subjekteve SPAR dhe JUMBO si dhe u kontaktua me administratorin e qëndrës tregëtare për marrje masash të menjëhershme, për eliminimin e zhurmave që shkaktohen nga gjeneratorët, kompresorët dhe pajisje të tjera të vendosur në pjesën e pasme të kësaj qëndre tregëtare. Kjo problematikë është ndjekur vazhdimisht nga ana jonë duke marrë dhe zgjidhje konkrete.

# DREJTIMI I TASK-FORCAVE, KOMITETEVE PËR ÇËSHTJE TË ÇAKTUARA

- ▶ Pranë Institucionit të Prefektit në zbatim të Nenit 14 të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, dhe akteve ligjore dhe nënligjore gjatë vitin 2020 janë ngritur dhe kanë funksionuar disa Task Forca, Komitete dhe grupe pune për problematika të ndryshme, veçanërisht ato në shërbim të komitetit si:

## Task Forca për:

- ❑ Emergjencat Civile ( tërmetet,përmytjet, zjarret, pandemia covid-19);
- ❑ Luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit;
- ❑ Plazhet dhe stacionet e plazheve, të mjeteve motorrike;
- ❑ Ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurma tej normave të lejuara;



# DREJTIMI I TASK-FORCAVE, KOMITETEVE PËR ÇËSHTJE TË CAKTUARA

- Anëtarët e këtyre Task Forcave, Komiteteve apo grupeve të punës të ngritura nën drejtimin e Prefektit të Qarkut, janë drejtues dhe nënpunës të Institucioneve të administratës shtetërore, të Degëve Territoriale që veprojnë në Qarkë si dhe të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të cilët gjatë zhvillimit të aktiviteteve kanë marrë pjesë, kanë zbatuar detyrat e përcaktuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Realizimi i këtyre detyrave është kryer nëpërmjet koordinimit të punës dhe bashkëpunimit mes Institucioneve Qëndrore dhe Vendore në nivel Qarku.
- Pavarësisht punës së mirë, problem mbetet pjesëmarrja dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve.



# TURIZMI

- ▶ **Gjatë vitit 2020 Institucioni i Prefektit nxori këto Urdhëra në drejtim të Turizmit:**
- ▶ Me urdhër të Prefektit nr.30, datë 30.06.2020 u riorganizua **Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit në nivel Qarku.**
- ▶ Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.85, datë 25.06.2020 "Për miratimin e Planit të Masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror për vitin 2020", Institucioni i Prefektit në bashkëpunim me Komitetin Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, hartoi dhe miratoi me **Urdhër nr. 24, datë 29.06.2020 "Planin e Masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror për vitin 2020 për qarkun Durrës"**. Ky plan u ndoq dhe u monitorua nga Inatitucioni i Prefektit dhe Komiteti Rajonal për Zhvillimin e Turizmit si dhe nga strukturat përgjegjëse.
- ▶ Një akt ligjor mjaftë i rëndësishëm ishte dhe Urdhëri i Përbashkët Nr. 353 datë 29.05.2020 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për "Miratimin e protokollit të masave Anti-COVID 19 përgjatë sezonit turistik", mbi bazën e të cilit u bënë dhe inspektimet e Task Forcës Anti-COVID 19 për respektimin e këtyre rregullave nga operatorët e ndryshëm.



# TURIZMI

**Më datë 04.03.2020** në Prefekturë nën drejtimin e Prefektit u zhvillua një takim në lidhje me **masat paraprake që do të merren në lidhje me turizmin** në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit, VKM-së Nr.171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" si dhe VKM-së 321 "Për ushtrimin e veprimtarive të sporteve ujore".

Në këtë takim ishin të pranishëm N/Kryetari i Bashkisë Durrës, Shefi i Urbanistikës së Bashkisë Durrës, Shefi i Policisë Bashkiake, Shefi i Rendit pranë Drejtorisë së Policisë Vendore që merret me sektorin e turizmit, Shefi i Stacionit të Policisë Plazh Durrës, Drejtori i Policisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, përfaqësuesi i Kapitenerisë, përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Drejtori i Shërbimeve Komunale Durrës, Drejtori i Shërbimeve Komunale Plazh, Drejtori i Ndërmarrjes Rruga Bashkia Durrës.



# TURIZMI

Në takim Prefekti nisur dhe nga eksperiencia e një viti më parë, vuri theksin mbi masat paraprake që duhet të merren në drejtim të stacioneve të plazhit, hartimit dhe miratimit të hartave të plazheve publik-privatë, krijimit e të gjithë infrastrukturës së nevojshme në këto stacione plazhi sipas kriterëve ligjore, dhënien përparësi të bizneseve hoteliere ashtu siç e përcakton ligji për plazhet privatë, si një garanci më e madhe në drejtim të sigurimit të kriterëve për stacionet e plazhit si (roje bregdetare, kulla vrojtimi, banjo, dushe etj), por edhe në lidhje me vendbazimet e mjeteve motorrike të sporteve ujore. Këto masa duhet të ishin sa më rigoroze dhe të marra në kohë me qëllim që fillimi i sezonit turistik 2020 të na gjej pa problematika në këtë drejtim.

Nga Prefekti iu kërkua strukturave përgjegjëse marrja e masave për, pastrimin e plazheve nga leshteriku dhe mbetjet inerte, plugimi dhe dezinfektimi i plazhit. Gjithashtu u kërkua vëmëndje e të gjitha strukturave në drejtim të marrjes së masave ndaj zhurmave, qarkullimit të mjeteve të rënda në zonën e plazhit, sinjalistikës së nevojshme, shitësve ambulantë etj.



# MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR DHE INSTITUCIONET E VETQEVERISJES VENDORE

Më datë **03.06.2020** është marrë pjesë në takimin që u zhvillua nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi me hotelierët dhe operatorët turistikë dhe strukturat përgjegjëse në kuadër të sezonit të ri turistik. Në këtë takim u shpjeguan **rregullat e menaxhimit të plazheve private dhe publike si dhe mënyra e aplikimit për stacione plazhi nga subjektet që i përcakton ligji në kushtet e luftës kundër COVID-19 në portalin “e-Albania”**. Hotelet do të aplikojnë për zonën që kanë para hotelit të tyre. Për sipërfaqe të tjera hotelet e vijës së dytë. Duke plotësuar 80% të plazheve dhe për t’ja lënë 20 % publikut. Plazhet pranë zonave të banuara do të jenë publike. Por dhe për ato plazhe të caktuara si private, kur nuk ka kërkesa, do t’i kalojnë publikut. Për mosrespektim të protokollit të shëndetësisë do të kishte sanksione shumë të forta (gjoba), deri në sekuestrime të pasurisë, shezlonëve dhe heqje të licencës. Në e-Albania aplikimet kanë nisur nga 1 qershori, deri në 15 qershor, në mënyrë që më 1 korrik gjithçka të ishte gati.

Në takim u trajtuan edhe dy çështje të rëndësishme siç janë **fenomeni i lypsërisë, si dhe ndotja akustike**, për të cilën Prefekti i Qarkut z. Nasto kërkoj koordinim dhe bashkëpunim ndër-institucional për menaxhimin sa më me efikasitet të këtyre problematikave.



# SEZONI VEROR, TURIZMI

Më datë 10.07.2020 nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Durrës Z.Roland Nasto u zhvillua **mbledhja e dytë e Komitetit Rajonal për Zhvillimin e Turizmit**, ku ishin të pranishëm drejtues të Institucioneve Vendore si dhe Degëve Territoriale anetarë të këtij Komiteti si dhe struktura të tjera mbështetëse mbi menaxhimin e sezonit turistik veror 2020.

**Në fjalën e tij Prefekti e vuri theksin në këto pika kryesore:**

1. Vlerësimin dhe zbatimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore, rregullave dhe protokolleve të sigurisë ndaj Covid 19 të dala nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirqënies Sociale si dhe Task Forca e ngritur për këtë qëllim.
2. Vlerësim dhe angazhim i Stukturave të Policisë së Shtetit, Policisë Kufitare dhe Migracionit, Policisë Bashkiake në lidhje me rendin dhe sigurinë në tërësi dhe në mënyrë specifike, angazhim maksimal për ecurinë dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik në qarkun tonë.
3. Angazhim të strukturave Portuale (Autoritetit Portual, Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, Kapitenerisë së Portit, Rregjistrisë Detar, Drejtorisë së Doganave, AFTO-s etj ,në krijimin e të gjitha kushteve për menaxhimin e fluksit të udhëtarëve dhe mjeteve që hyjnë dhe dalin në porti detar Durrës.
4. Ndjekja, koordinimi dhe monitorimi i punës mbi masat e marra për fillimin e sezonit të ri turistik 2020 në kushtet e pandemisë, nga të gjithë degët territoriale që ofrojnë shërbime në këtë drejtim, si dhe masat e marra nga njësitë e vetqeverisjes vendore në këtë drejtim.
5. Garantimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor 24 orë në 24.

## SEZONI TURISTIK

6. Vazhdimi i dezinfektimit të zonave turistike.

7. Sigurimi i furnizimit me energji elektrike 24 orë në 24 dhe furnizimin me ujë të pijshëm në të gjithë zonën turistike.

8. Ngritja e Task Forcës “Për monitorimin dhe kontrollin e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë në plazhe gjatë sezonit turistik veror” si dhe vazhdimi i kontroleve dhe inspektimeve nga Task-Forca në kuadër të mos përhapjes së COVID-19 dhe zbatimit të protokolleve (kjo me pjesmarrjen e ISHSH si kryesore në bashkëpunim me AKU, Inspektoratin e Punës, dhe Policinë e Shtetit etj)

Për të pasur një ecuri sa më të mirë dhe të sigurt të sezonit turistik veror u kërkua angazhimi i bashkive dhe në mënyrë specifike i të gjithë drejtorive mbështetëse.



## TASK-FORCA VENDORE PËR PLAZHET

Më datë 11.07.2020 filloi puna në terren e TASK - FORCËS “Për monitorimin dhe kontrollin e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë në plazhe gjatë sezonit turistik veror 2020. Grupi i punës do të kryej monitorimin e situatës dhe kontrollin e masave të marra nga subjektet për sigurinë në plazhe dhe hapsirën ujore, gjatë sezonit turistik veror 2020, në zbatim të VKM-së Nr.171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" të ndryshuar si dhe në mënyrë të veçantë marrjes së masave anti COVID19 nga subjektet që operojnë në vijën bregdetare, kjo në respektim të protokollit të masave anti COVID 19 gjatë sezonit turistik veror 2020. Gjatë kësaj periudhe Task Forca ka inspektuar të gjithë vijën bregdetare të plazhit të madh.



# SEZONI TURISTIK

**Gjatë sezonit turistik** në bashkëpunim dhe me Bashkinë Durrës, Policinë bashkiake, Institucioni i Prefektit i ka kushtuar vëmendje monitorimit të zonave të plazhit, moslejimit të zënies së hapsiravë me shazllone nga individë, të cilët nuk kishin asnjë leje për ushtrim aktiviteti. Operacioni kundër zaptimit të pronës publike në kundërshtim me Aktin Normativ për situatën e krijuar nga COVID-19 ka qënë i vazhdueshëm gjatë periudhës verore. Ka patur kontrole të shtuara në zonën bregdetare nga Policia e Durrësit, në bashkëpunim me Policinë bashkiake, ku janë ndaluar dhe proçeduar edhe persona që vepronin në kundërshtim me rregullat anti COVID 19.

**Në lidhje me sektorin e Turizmit**, lidhur me të ardhurat përfundimtare për plazhet privat për vitin 2020 rezultojnë si më poshtë:

Planifikimi për vitin 2020 për këtë zë ka qënë 60,000,000 lek.

Realizimi i tarifës së plazheve private për vitin 2020 në Bashkinë Durrës, deri më 31.08.2020 ishte në vlerën 72,424,823 lek.





# SEZONI TURISTIK, RISITE, REZULTATET

## PROBLEMATIKA & DETYRA PËR 2021

### Problematika

- Problem mbetet mos realizimi në kohë i detyrave dhe përgjegjësive që kanë disa struktura në drejtim detyrave funksionale dhe ligjore, si dhe në drejtim të menaxhimit të sezonit turistik. Kjo vjen për arsye të ndryshme teknike, organizative, mungesë planifikimi dhe menaxhimi, mungesë burimesh njerëzore, por edhe mungesë fondesh.

### Detyrat

Analizimi nga çdo strukturë përgjegjëse i situatës dhe problematikave të dala gjatë sezonit turistik kryesisht për sigurinë në zonat bregdetare dhe sektorit të turizmit në tërësi.

- Objektiv mbetet shtrirja e turizmit gjithëvjetor duke shfrytëzuar të gjithë potencialet, asetet dhe burimet që kanë njësitë e vetqeverisjes vendore (Bashkia Durrës, Krujë e Shijak) për shtrijen e turizmit gjatë gjithë vitit në territoret e tyre.

# ARSIMI

- ▶ Më datë 12 maj 2020 në mjediset e Institucionit të Prefektit të Qarkut Durrës u zhvillua mbledhja me drejtorin e DRAP Durrës (Drejtoria e Rajonale të Arsimit Parauniversitar) znj. Valentina Leka, me drejtorin e ZVA Shijak (Zyrës Vendore Arsimore) znj. Blerina Keçi dhe ZVA Krujë (Zyrës Vendore Arsimore) znj. Dorina Laçi, ku u diskutuan një sërë çështjesh të lidhura ngushtë me procesin në vijim të mësimdhënies online për sistemin parauniversitar në të gjithë qarkun në platformat Google Classroom dhe Zoom Live. Njëkohësisht u diskutuan direktivat e parashtruara nga urdhëri i posaçëm datë 18.05.2020 bazuar në urdhërin nr. 45 datë 29.04.2020 “Për organizimin e mësimin vlersimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019-2020” për klasat e 12-ta nga data 18 maj deri me 5 qershor 2020 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe ri-hapja e shkollave vetëm për maturantët të cilët do të duhet të kryejnë procesin e përsërtijeve para provimeve të maturës shtetërore në datat nga 08-18 qershor 2020. Gjithashtu gjatë mbledhjes u diskutuan edhe çështje të tjera tepër të rëndësishme si:



# ARSIMI

- ▶ Prishja e një numri të konsiderueshëm shkollash dhe rindërtimi i tyre në një kohë të shpejtë për të qenë gati dhe funksionale për vitin e ri shkollor 2020-2021. Shkollat e prishura për shkak të dëmtimeve të konsiderueshme nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 janë: ZVA Durrës 12 shkolla, 1 konvikt dhe 3 kopshte, ZVA Shijak 3 shkolla dhe ZVA Krujë 14 shkolla dhe 5 kopshte.
- ▶ E rëndësishme ka qenë edhe zgjidhja e transportit të nxënësve si pasojë e pezullimit të transportit publik nga COVID-19; dezinfektimi i mjediseve shkollore; ruajtja e largësisë midis nxënësve prej 2 m nga njëri-tjetri dhe vetëm 7 nxënës për çdo klasë; nënshkrimi i një deklaratë nga ana e prindërve të cilët pranojnë kushte e vendosura për mbrotjen dhe parandalimin e përhapjes së infeksionit mes nxënësve gjatë periudhës së përsëritjeve të njohurive para provimeve të maturës shtetërore; vendosja në mjediset e institucioneve shkollore parauniversitare të 1 mjeku dhe 1 infermjeri në shërbim të nxënësve;

Nga data 18 - 22 maj 2020 Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës kreu inspektime në të gjitha gjimnazet e Rrethit Durrës. Inspektimi kishte për qëllim kontrollimin e zbatimit të urdhërit të posaçëm datë 18.05.2020 bazuar në urdhërin nr. 45 datë 29.04.2020 “Për organizimin e mësimin, vlersimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019-2020” për klasat e 12-ta, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjatë inspektimit të institucioneve shkollore të sistemit parauniversitar u vërejt respektimi dhe zbatimi me rreptësi i të gjitha rregullave sipas protokollit për kohëzgjatjen e procesit të konsultimeve për maturën shtetërore 2019-2020. (lexim)

# ARSIMI

## Arsimi për përgatitjen e hapjes së shkollave për vitin shkollor 2020-2021:

- ▶ Inspektime të shpeshta kanë vijuar edhe gjatë muajit gusht nga Institucioni i Prefektit përkatësisht më datë 20 gusht 2020 u inspektuan të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në Bashkinë Durrës, Krujë dhe Shijak, të cilat u shembën si pasojë e dëmtimeve të rënda nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Qëllimi i inspektimit ishte kontrolli për pastrimin e inerteve të godinave të shembuar, fillimi i procesit të rindërtimit të këtyre institucioneve të arsimit parauniversitar dhe kompletimin me bazë materiale të shkollave të rikonstruara së fundmi në qytetin e Durrësit. Institucionet e arsimit parauniversitar të inspektuara në nivel qarku janë: 14 objekte arsimore në Bashkinë Durrës, 15 objekte arsimore në Bashkinë Krujë dhe 3 objekte në Bashkinë Shijak.



# ARSIMI

**Më datë 31 gusht 2020** u inspektuan të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në bashkitë e Qarkut Durrës për përgatitjen e hapjes së shkollave dhe kryerjen e dezinfektimit të mjediseve shkollore në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021.

- ▶ Procesi i inspektimit ka vijuar edhe gjatë muajit shtator, ku më datë 01.09.2020 u inspektuan disa prej institucioneve arsimore parauniversitare në Rrethin e Durrësit nga Sektori i Kompetencave Vendore dhe Funkcioneve të Deleguara me qëllimin për të kontrolluar kryerjen e procesit të dezinfektimit. Institucionet arsimore të inspektuara ishin 30 shkolla të sistemit parauniversitar në Qarkun Durrës:



# ARSIMI

- ▶ **Me datë 08.09.2020** u inspektuan nga Sektori i Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, institucionet e arsimit parauniversitar në të tria ZVA-t e Qarkut Durrës. Synimi i këtij inspektimi ishte kontrolli për masat e marra në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021 dhe respektimi i protokollit të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për parandalimin e infektimit të nxënësve dhe trupës mësimore nga COVID-19.
- ▶ Gjatë muajit shtator, në zbatim të planit të punës Institucioni i Prefektit dhe në zbatim të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në fushën e arsimit dhe në zbatim të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektim e Qarkut” neni 8 pika g dhe b, në kuadër të përgatitjeve dhe masave të marra për fillimin e vitit të ri arsimor 2020-2021, në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia e COVID -19, Prefekti i Qarkut Durrës ndoqi në vazhdimësi procesin e përgatitjeve në nivel Qarku.



# ARSIMI

- ▶ Në shtator ishin gati për fillimin e procesit mësimor në nivel Qarku 73 institucione arsimore publike, ku do të studjonin 38.488 nxënës.
- ▶ Bashkia Durrës ka 57 institucione arsimore nga të cilat 39 ishin të gatshme për fillimin e mësimit dhe 18 institucione arsimore ishin të demoluara dhe kishte filluar puna për rindërtimin e tyre.
- ▶ Bashkia Krujë ka 38 institucione arsimore nga të cilat 25 ishin të gatshme për fillimin e mësimit dhe 13 institucione arsimore ishin të demoluara dhe kishte filluar puna për rindërtimin e tyre.
- ▶ Bashkia Shijak ka 14 institucione arsimore nga të cilat 8 ishin të gatshme për fillimin e mësimit dhe 6 institucione arsimore ishin të demoluara dhe kishte filluar puna për rindërtimin e tyre.
- ▶ Në të gjitha Bashkitë dhe ZVAP-t e Qarkut Durrës u morën masa të mira teknike, organizative dhe logjistike për një fillim të mbarë. Nga të tre bashkitë u krye procesi i dezinfektimit, riparimeve, lyrjes, pastrimit dhe furnizimit me bazë material (dezinfektant, detergjent, kite higjienike dhe maska). U vendosën postera orientues dhe shpjegues për masat kundër COVID-19 dhe udhëzues për mënyrën e sjelljes së nxënësve në shkolla.
- ▶ Kompletimi tërësor me sinjalistikën horizontale orientuese për ruajtjen e largësisë së kërkuar sipas proktokollit të Ministrisë së Shëndetësisë kundër COVID-19. U caktua personel infermjerësh për çdo institucion arsimor.



# ARSIMI

- ▶ Me datë 14.09.2020 filloi viti i ri shkollor 2020-2021. Institucioni i Prefektit u impenjua për të qenë i pranishëm në disa nga shkollat e Rrethit Durrës, duke vëzhguar me shumë kujdes të gjithë procesin e ditës së parë të shkollës në kushte jo të zakonshme, për shkak të pandemisë Covid-19. Pas një periudhe të gjatë të zhvillimit të mësimin në kushtet e shtëpisë në vitin e kaluar shkollor, nxënësit e 106 shkollave të arsimit parauniversitar në Qarkun e Durrësit u ulën në bankat e shkollës.
- ▶ Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës ndoqi ecurinë e mbarëvajtjes së procesit mësimor për vitin shkollor 2020-2021, në bashkëpunim me Drejtuesit e Institucioneve Arsimore të Qeverisjes Vendore dhe Drejtuesit e Policisë së Shtetit, për të bërë të mundur garantimin e masave të nevojshme në strukturat arsimore parauniversitare në drejtim të kushteve higjieno-sanitare, infrastrukturës shkollore, pajisjen me bazë materiale si dhe ruajtjen e distancës fizike me qëllimin për t'i siguruar nxënësve dhe mësuesve rritjen e nivelit të sigurisë publike në mjediset e institucioneve arsimore, si dhe ofrimin e kushtve sa më të mira për një fillim sa më të mbarë të vitit të ri shkollor 2020-2021.





# ARSIMI

- ▶ Me datë 16.09.2020 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës në kuadër të hapjes së vitit të ri shkollor 2020-2021 u zhvillua takimi me Drejtoreshën e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor znj. Aurora Hyka, në lidhje me paisjen e shkollave me personel shëndetësor, menaxhimin dhe koordinimin sa më efikas të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë COVID -19. Prefekti i Qarkut Durrës ashtu si deri më sot do të punojë në mënyrë të vazhdueshme, për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore e shëndetësore, njësisive të vetëqeverisjes vendore, policisë vendore, institucione të tjera dhe komunitetit për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë vitit arsimor 2020-2021.
- ▶ Me datë 17.09.2020 Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës zhvilloi një takim pune me drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar në Durrës znj. Valentina Leka. Qëllimi i këtij takimi ishte fillimi i vitit të ri shkollor 2020-2021, ku u shtruan për diskutim një seri çështjesh dhe problematikash për një mbarvajtje sa më të mirë të vitit të ri shkollor në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në Qarkun e Durrësit.



# ARSIMI

- ▶ **Më datë 29.09.2020** në mjediset e Institucionit të Prefektit të Qarkut Durrës u mbajt takimi midis përfaqësuesve të Prefekturës Durrës (Sektori i Mbrojtjes Civile dhe Sektori i Kompetencave Vendore dhe Funkcioneve të Deleguara), Njesisë Vendore të Shëndetit Publik, Kryqit të Kuq Shqiptar, Zyrës Vendore Arsimore Durrës, Bashkisë Durrës dhe Drejtorisë së Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit në Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Ky takim u mbajt në kuadër të datës 13 Tetor, “Ditës Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë” dhe aktiviteteve që do të organizohen për këtë qëllim. Në këtë takim paraprak u realizua një paraqitje e hollësishme e programit informues të miratuar nga AKMC, “Mbi Mbrojtjen Civile dhe Rreziqet Kryesore në Shqipëri” i shoqëruar me bazë materiale të pasur dhe fletëpalosje. Gjithashtu gjatë takimit u diskutua mbi objektivat kryesore dhe përmirësimin e punës së përbashkët në përcaktimin e informacionit sensibilizues që do të paraqitet në këto aktivitete.
- ▶ Nga data 14 shtator e në vijim përpunohen të gjithë të dhënat për infektimin e nxënësve dhe mësuesve në Qarkun Durrës. Një proces i koordinuar ngushtësisht me Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor të Rrethit Durrës dhe Rrethit Krujë, ku çdo ditë përpunohen raportimet ditore me të infektuarit e ri, duke ia dërguar Zyrës Operacionale të Situatës në Kryeministri (ZOS), më pas bëhet përmbledhja javore dhe ajo mujore.

## PERIUDHA ANTI COVID-19

**Gjatë gjithë vitit 2020, përgjatë gjithë periudhës së izolimit ndaj COVID-19, por edhe në vazhdimësi Institucioni i Prefektit ka ndjekur detyrat si më poshtë:**

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19, e në vazhdimësi kemi zbatuar dhe konfirmuar të gjitha masat e veçanta administrative të marra nga Keshilli i Ministrave, Urdhërat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrive të tjera si dhe Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile.



# PERIUDHA ANTI COVID-19

- ▶ Janë përcjellë elektronikisht të gjitha Vendimet dhe Udhëzimet e dala nga Komiteti Ndërmintor për Emergjencat Civile të tre Bashkive si dhe janë mbajtur kontakte të përditshme me strukturat e të tre bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë lidhur me problematikat që ata kanë pasur gjatë periudhës së pandemisë.
- ▶ Është ndjekur dhe dërguar pranë ZOS, Ministrisë së Brendshme informacione ditore lidhur me monitorimet dhe inspektimet nga Task-Forca e drejtuar nga Prefekti e Masave Lehtësuese, lidhur me zbatimin e rregullave/masave në përputhje me udhëzimet dhe protokollet e parashikuara me vendim të Komitetit Ndërmintor për Emergjencat Civile, në kuadër të masave dhe zbatimit të rregullave kundër Covid-19.



## PERIUDHA ANTI COVID-19

Është dërguar informacion ditor pranë ZOS dhe Ministrisë së Brendshme lidhur me ecurinë e Qarkut Durrës për situatën e krijuar nga Covid-19. Për këtë është ndjekur në mënyrë periodike ditore ecuria e situatës epidemiologjike në të gjithë qarkun Durrës, ku shifrat e gjendjes së janë që nga fillimi i pandemisë deri në fund të muajit Dhjetor kanë qenë 4636 persona me COVID-19 (Durrësi & Shijak 3035 dhe Kruja 1601). Nisur nga situata e krijuar në bashkinë Krujë dhe Durrës pas shtimit të numrit të infektuarve me COVID-19, janë forcuar masat në fashione, call center, shkolla dhe bar-bufe- restorante, kopshte, cerdhe, si dhe janë njoftuar të gjithë për kujdesin e shtuar, është bërë kontrolli i personave dhe familjareve të prekur, të cilët janë urdhëruar të futen në karantinë dhe të zbatojnë të gjitha rregullat.

Është dërguar informacion ditor Ministrisë së Brendshme lidhur me shpërndarjen e barnave mjekësore (ilace) dhe pakove në ndihma ushqimore (tabela) për të tre bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë.

Po kështu është ndjekur dhe monitoruar situata në bashkëpunim me strukturat e DVP të qarkut Durrës, të cilat kanë vazhduar përgjatë gjithë vitit me patrullimet dhe kontrollet në rrugë sheshe, lagje dhe plazhe. Gjithashtu nga policia janë mbajtur nën mbikqyrje personat që kanë rezultuar pozitiv me COVID-19 në të gjithë territorin e qarkut Durrës.



## PERIUDHA ANTI COVID-19

- Që prej 11 Marsit nga Italia në pikën e kalimit kufitar (sheshi i trageteve/ terminali i pasagjerëve) në Portin e Durrësit nuk ka pasur pasagjer (deri me mbarimin e gjëndjes së jashtëzakonshme) por vetëm anije tregtare dhe tragete me kamiona për të gjithë këto persona është ndjekur nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës e njejtat procedurë, sipas urdhërit të MSHMS për karantinimin e detyruar për këto persona, nga stafet e kësaj drejtorie të vendosura në port, çdo personi ose fizikisht ose verbalisht i është komunikuar ky urdhër. Gjithashtu nga skedat e marra për personat të cilët duhet të karantinohen por që nuk janë banorë të Durrësit, listat me emra dhe kontakte nga shërbimi epidemiologjik i njësive janë komunikuar këto emra qyteteve të tjera që ndiqnin qëndrimin në karantinë të këtyre personave.
- Nga qendrat Shëndetësore përparësi kanë pasur të sëmurët kronik, këshillimi dhe monitorimi nëpërmjet telefonit dhe vizitave këshilluese. Në vëmendje çështja e medikamenteve të gjitha QSH kanë ndjekur me rigorozitet urdhërat dhe protokollet që u dhane nga MSHMS.



## PERIUDHA ANTI COVID-19

Me shpalljen e gjëndjes së Fatkeqësisë Natyrore në dt 24.03.2020 dhe në mbështetje të Ligjit 107/2016 “ Për Prefektin e Qarkut” Ligjit nr 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” VKM 236 dt 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistences në banesë ndaj shtetasve në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 si dhe udhëzimeve të ardhura nga MB, Prefekti i Qarkut Durrës ndërmori masat e mëposhtëme:

Prefekti i Qarkut Durrës pas marrjes së udhëzimeve në takim me Ministren e Mbrojtjes Znj Olta Xhaçka dhe Drejtorin e AKMC Z. Haki Çako me të gjithë Prefektët e Qarqeve me Urdhër nr 46, datë 21.03.2020 ngriti Komisionin e Mbrojtjes Civile në qark (Shtabi koordinues i qarkut) me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm dhe raportimin në Komisionin Qëndror për Ofrimin e Asistencës. Prefekti i Qarkut caktoj pikat e kontaktit që komunikojnë elektronikisht me institucionet përgjegjëse anëtarë të komisionit të Mbrojtjes Civile lidhur me veprimtarinë ditore të punës. Informacioni pasi mblidhet nga punonjësit e administratës së Prefektit si pika e kontaktit përpunohej dhe i kalohej Sekretarit të Përgjithshëm i cili ja kalonte Prefektit dhe ky e përcillte pranë AKMC.

Puna ishte e koordinuar ndërmjet Bashkive, Njësi Administrative dhe Degëve Territoriale për zbatimin e të gjitha masave të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, MASR, dhe MB për mospërhapjen e virusit COVID -19.

## PERIUDHA ANTI COVID-19

Nisur nga situata dhe për të mundësuar një mbledhje në kushte normale Prefekti ka zhvilluar vazhdimisht konferenca call dhe komunikime online me të tre kryetarët e bashkive dhe drejtuesit e degëve territoriale për zbatimin e masave dhe udhëzimeve mbi marrjen e masave për menaxhimin e situatës COVID-19. është koordinuar veprimtaria mes institucioneve përgjegjëse në mënyrë që asnjë qytetar në nevojë mos të ngelej pa marrë shërbimin e nevojshëm në ushqime apo medikamente.

Në Institucionin e Prefektit punohej në grupe kolektive në terren dhe online nga shtëpitë. Çdo ditë në punë kishim 4 persona me personel të reduktuar.

Në zbatim të Vendimit Nr 243, datë 24.03.2020 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore ” si dhe me qëllim përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore , të gjithë Degëve Territoriale të Qarkut dhe Bashkive ju dërgua një shkresë dhe program pune me detyra konkrete për zbatim.

**Ka vazhduar** puna për zbatimin e Vendimit Nr 236 datë 19.03.2020”Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Për këtë nga bashkitë u përgatitën listat e personave /familjeve të cilët nuk kanë familjarë të aftë për punë në NJ AD ku jetojnë dhe që bëjnë pjesë në grupet e mëposhtëme;

-Familjet/individë në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike.

- Personat me aftësi të kufizuar

- Personat të cilët përfitojnë pension pleqërie.

- Personat:

1. Familje individë të pastrehënë nevojë.

2.personat që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit,


3. personat të cilët përfitojnë pension pleqërie.



# MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR DHE INSTITUCIONET E VETQEVERISJES VENDORE

Në vazhdimësi kemi mbajtur kontakt të vazhdueshëm dhe kemi bashkëpunuar për të gjitha vendimet dhe aktet normative të Qeverisë për ti zbatuar në kohë dhe me cilësi, në situatën e luftës kundër COVID-19.

1. Të tre bashkitë nëpërmjet strukturave të tyre në vazhdimësi sipas një plani të vecantë të tyre kanë kryer disinfektimin e të gjitha ambjenteve.
2. është bashkëpunuar me bashkitë, Njësitë Administrative, kryepleqtë për të kryer verifikimin dhe kontrollin e të gjithë shtetasve Shqiptarë dhe të huaj rezident në Shqipëri, që kanë hyrë nga Italia, Greqia apo Europa në Republikën e Shqipërisë, nga data 27.02.2020 e në vijim në Qarkun e Durrësit dhe sipas listës së nxjerrë nga sistemi TIMS, detyrë për të frenuar përhapjen e COVID-19.
3. Në kufizimin e lëvizjeve dhe mbylljen e lokaleve policia Bashkiake ka qënë në krye të detyrës dhe ka bashkëpunuar me Policinë e Shtetit.



# NDIHMAT

Në kuadër të urdhërit të Kryeministrit për të ndihuar familjet që jetojnë në çadra të dëmtuar nga tërmeti i 26.11.2019, për të moshuarit e dëmtuar dhe të pamundurit në të tre bashkitë janë ndarë ndihma nga Rezervat e Shtetit të ndihmuar nga MM dhe Drejtoria Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Nga bashkitë dhe nga Shteti ka vijuar shpërndarja e ndihmave dhe ofrimi i asistencës për shtresat në nevojë. **Deri në fillim të muajit qershor ndarja e ndihmave paraqitet si më poshte : Durrësi 4866 pako, Kruja 4446 pako, Shijaku 1517 pako, si qark në total 10829 pako ushqimore dhe detergjente në terësi.**

Të gjitha ndihmat janë ndarë për familjet në çadra, të moshuarve, familjeve në nevojë dhe të pamundurve, kundrejt firmës për çdo familje që merret pakon e ndihmës dhe kundrejt ID kartë.

Për çdo bashki u ngrit dhe funksionoi shtabi koordinues i bashkisë, njësitë koordinuese në terren dhe zbatuesit në terren për çdo Njësi Administrative.(kjo për periudhën e emergjencës).



## TASK-FORCA ANTI COVID -19

Më datë 27.04.2020 në Qarkun e Durrësit u ngrit Task Forca e Masave Lehtësuese të kryesur nga Prefekti i Qarkut. Kjo strukturë monitoruese u ngrit për zbatimin e Masave Lehtësuese të ndërmarra nga qeveria në kuadër të luftës kundër COVID- 19. Task Forca e Masave Lehtësuese përbëhej nga insitucionet e mëposhtëme: ISHSH, AKU, Tatim Taksa, Inspektoriati i Punës, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake, strukturë që ka vazhduar normalisht inspektimet kontrollet dhe monitorimet sipas planit të detajuar javor në bizneset e qarkut gjithashtu Njësitet e Vetqerisjes Vendore dhe Degët territoriale kanë vazhduar punën e tyre në zbatimin e detyrimeve ligjore dhe planit të veprimit të Prefektit të Qarkut për situatën e krijuar si pasoje e pandemisë COVID -19.



# TASK-FORCA ANTI COVID-19

- ▶ Task Forca Anti Covid -19 e ka përqëndruar punën e saj në pikat më sensitive në qark, si subjektet ekonomike (fasone call center) që kanë një numër të konsiderueshëm punonjësish, tregjet e fruta perime me shumicë dhe pakicë, menaxhimin e situatës para bankave, pikave të postës, marketeve ushqimore, shkollave çerdheve spitaleve bar bufeve,restoranteve etj. Sensibilizimi i vazhdueshëm i qytetarëve për marjen e masave sidomos për vendosjen e maskës dhe distancimit social. Kontrollat e Task-Forcës me përbërje ISHSH, AKU, Tatim-Taksa, ISHPSHSH,ISHRR dhe mbështetje të policisë së shtetit si dhe krimi ekonomik kanë vazhduar monitorimet dhe kontrollat kryesisht në tre Bashkitë e Qarkut të Durrësit. Janë kryer kontrollat dhe monitorime në subjekte të ndryshme.
- ▶ **Grupi i Task Forcës Anti Covid-19 gjatë vitit 2020 ka kryer 419 inspektime, 60220 monitorime dhe 153 masa administrative.(për periudhën 12Mars deri 31 Dhjetor 2020)**
- ▶ Shërbimi i Epidemiologjisë, NJVKSH, QSH, Spitalet Rajonale Durrës dhe Krujë kanë ndjekur në vijimësi këtë proces. Shifrat e gjendjes nga fillimi pandemisë deri në fund të vitit **gjithsej si qark të infektuar aktiv janë 4636 (Durrës Shijak 3035, Kruja 1601), në total të vdekur në qark janë 101 persona. Të shëruar janë 4203 persona.**



# RIATDHESIMI

Gjatë periudhës mars-prill është ndjekur Riatdhesimi, shtetësave shqiptarë. Ka vazhduar normalisht ku ne si qark kemi ndjekur 5 hotele në rajonin e plazhit të Durrësit : Hotel Sun 84 persona, Hotel Horizont 181 persona, Hotel Alvin 42 persona, Hotel Dion 19 persona, Hotel Bleart 153 persona dhe Kavalishenca e Ministrisë së Mbrojtjes 75 persona, gjithsej 554 persona të riatdhesuar.



# MARËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

**-Gjatë kesaj periudhe është punuar kryesisht me verifikimin dhe miratimin e kërkesave për përfitimin nga paketa e ndihmës, e parë, e dytë deri tek e katërta, si dhe me verifikimin e ankesave të tatimpaguesve dhe individëve për mos përfitimin nga kjo paketë.**

Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës në zbatim të akteve ligjore ka trajtuar të gjithë kërkesat e tatimpaguesve në kuadër të paketave të ndihmës aplikuar nga qeveria.

Nga ana e DRT Durrës janë trajtuar të gjithë kërkesat e për paketën e parë si dhe ankesat e kryera nga tatimpaguesit lidhur me këtë paketë.

Paketa e dytë është trajtuar pjesërisht nga ana e DRT Durrës dhe pjesërisht në mënyrë automatike nga sistemi. Gjithashtu janë trajtuar gjithë ankesat për këtë paketë.

Paketa e katërt është trajtuar tërësisht në mënyrë automatike nga sistemi

Në mënyrë progresive në tabelën më poshtë po japim një pasqyrim të gjithë kërkesave për ndihmë financiare për tre paketat e ndihmës sipas statistikave të sistemit tatimor për DRT Durrës.



# MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

DRT Durrës		Kerkesat per Ndihme Financiare					
DRT Durrës	Kerkesat per Ndihme Financiare						
	Paketa pare		Paketa dyte		Paketa Katert		
	Subjekte	Punonjes	Subjekte	Punonjes	Subjekte	Punonjes	
<b>Kerkesa gjithsej</b>	7318	13117	6429	22442	211	8391	
<b>kerkesa verifikuara</b>	7318	13117	6429	22442	211	8391	
<b>Kerkesa te Miratuara</b>	3,981	6,454	6132	19597	211	8391	
<b>Kerkesa te Refuzuara</b>	3,337	6,663	297	2845			
<b>Ankesa gjithsej</b>	943		1561	15572			
<b>Verifikuar</b>	943		1561	15572			
<b>Rezultojne te padrejta</b>	608		957	11663			
<b>Rezultojne te drejta</b>	335		604	3909			

# PERIUDHA PAS TËRMET

## Në DREJTIM Të VEPRIMTARISË Së PAS TËRMETIT Të 26 Nëntor 2019

I gjithë procesi i menaxhimit të situatës pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019, ka kaluar nëpër etapa dhe programe të vështira dhe mjaftë sfiduese për të gjithë strukturat si ato në nivel qëndror ashtu edhe në nivel vendor. Angazhimi i çdo strukture sipas kopetencave që i përcaktonte ligji ka qënë maksimal, një angazhim sfidues aq sa për një periudhë 1-vjeçare janë ndërmarrë dhe realizuar sfida, të cilat as që mund të imagjinoreshin. Të gjitha këto u realizuan me synimin e vetëm që ky qark duhet të rifillonte jetën në një kohë sa më të shpejtë, aty ku e ndërpreu tërmeti i 26 Nëntorit. Angazhimi maksimal i Qeverisë Shqiptare në këtë drejtim ka qënë maksimal duke dhënë jo vetëm mbështetje financiare, logjistike dhe humane, por duke na treguar dhe mësuar në të njëjtën kohë mënyrën e duhur dhe efikase të trajtimi të një emergjence prej një fatkeqësie natyrore të përmasave të tilla.

Në këtë kontekst Institucioni i Prefektit ka luajtur një rol thelbësor në përballimin dhe menaxhimin e kësaj situate, në mbështjetjen e çdo strukture të nivelit vendor apo dhe dege territoriale, si dhe në trajtimin e çdo problematike që ka dalë gjatë kësaj periudhe (të cilat kanë qënë të shumta) në kohë dhe me efikasitet.

**Gjatë periudhës Janar - Dhjetor**, i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë problematikës së post tërmetit kryesisht në marrjen e informacionit në mënyrë të përditësuar në lidhje me familjet e prekura nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në të tre bashkitë e Qarkut Durrës.

Periudha pas tërmetit për të tre bashkitë e Qarkut ka qënë një periudhë e vështirë si me strehimin e banorëve, dhënien e ndihmave, në përgatitjen e dokumentacionit për ndërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti, ndarja e grandeve, procesi i rindërtimit etj.



# PERIUDHA PAS TËRMET

**Gjatë Vitit 2020 Institucioni i Prefektit dhe sektorët përgjegjës një vëmendje e veçantë i kanë kushtuar të gjithë procesit të rindërtimit si pasojë e tërmetit të 26 Nëntorit 2019. Vëmëndja jonë u përqëndrua kryesisht në këto pika: Njohja me të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave për çështjen e menaxhimit të situatës së pas tërmetit të 2019.**

Njohja dhe ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara në të tre bashkitë e qarkut Durrës të hartuara nga Ministri i Shtetit për Rindërtim dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Raportimet të informaconeve të vazhdueshme periodike, si dhe ndjekja dhe zgjidhja e çdo problematike që dilte në këtë drejtim.

Me fillimin e vitit 2020 Institucioni i Prefektit bëri planin e ndjekjes së situatës pastërmet të ndarë sipas sektorëve sipas drejtimeve të më poshtëme:



# PERIUDHA PAS TËRMET

**1. Akomodimit në hotele të familjeve të prekura nga termeti në tre bashkitë**

**Lidhja e kontratave me 14 hotele** (Kolaveri, Fafa, Prestige, Pameba, Pishat e Buta, Aler, Eter, Kasa, Dolcevita, AS/Ibisa, Diamma, Bonita, Vala dhe Arragosta) ku akomodohen gjithsej **rreth 2700 persona.**

**Akomodimi i familjeve në hotelet pa kontrat** (Florida, Adriatiku, Adriatik-2, Blearti, Kompleksi Hëna) **gjithsejt 331 persona** dhe në kishën e Shënavlashit **197 persona.**

**Në këto hotele ndihma me produkte ushqimore dhe ujë ka qënë nga Institucioni i Prefektit në b/p me bashkinë e Durrësit.**



## PERIUDHA PAS TËRMET

Në Bashkinë Krujë banorë të strehuar në hotel Grand Krujë janë 80 vetë, ndërsa në hotel Rafaelo në Shëngjin janë strehuar 180 vetë.

Në Durrës gjithësej rreth 2681 persona të shpërndarë sipas hoteleve në Janar 2020 me një diferencë prej 212 banorësh nga viti 2019.

### 2. Zëvendësimi i çadrave verore me ato dimërore në zonat rurale.

Bashkëpunimi me MM, AKMC, Institucioni i Prefektit dhe Njësitë Administrative si dhe me ndihmën e KM u bë i mundur zëvendësimi i çadrave verore me ato dimërore në të gjithë qarkun në zonat rurale.

**Tabela e çadrave dhe kontainereve sipas Bashkive për çdo Nj/Ad Qarku Durrës**

Bashkia	Njesia Administrative	Gjendja aktuale e çadrave	Numri i banoreve ne cada	Nevoja per çadra dimerore duke zevendesuar veroret	Kontainer	Numri i familjeve ne kontainer	Numri i banoreve ne kontainer
<b>Durres</b>							
	Ishem	295	1095	0	23	23	99
	Katundi Ri	53	202	0	2	2	10
	Sukth	30	133	0	0	0	0
	Rrashbull	38	179	0	0	0	0
	Manze	308	778	0	15	34	105
<b>Total Durres</b>		724	2387	0	40	59	214

## PERIUDHA PAS TËRMET

<b>2</b>	<b>Shijak</b>							
		Shijak	11	47	0	0	0	0
		Gjepalaj	81	269	0	9	9	42
		Maminas	106	390	0	9	9	40
		Xhafzotaj	11	17	0	0	0	0
	Total Shijak		209	723	0	18	18	82
<b>3</b>	<b>Kruje</b>							
		Qytet Kruje	57	182	0	0	0	0
		Fush Kruje	100	374	0	0	0	0
		Bubq	225	1153	0	0	0	0
		Nikel	33	168	0	0	0	0
		Thumane	235	718	0	0	0	0
		Cudhi	43	150	0	1	1	5
	Total Kruje		693	2745	0	1	1	5
	<b>Total Qarku</b>		1626	5855	0	59	78	301

# PERIUDHA PAS TËRMET

Një b/p i ngushtë me MM, AKMC, SHP të FA, Njësitë Administrative dhe grupi i Institucionit të Prefektit u bë e mundur ngritja e të gjitha çadrave në kohë rekord dhe zëvendësimi i çadrave verore me ato dimërore.

Në fund të muajit Prill nga ndarja e bonusit të qirasë dhe në zonën rurale u bë e mundur ulja e numrit të familjeve që qëndronin në çadra.

Durrësi 478 familje, 1645 banorë, Shijaku 194 familje, 677 banorë dhe Kruja 624 familje dhe 2732 banorë.

Numri i familjeve ka ardhur në ulje dhe mund të themi që në fund të vitit 90% e tyre kanë marrë bonusin e qirasë, përveç atyre që nuk donin të largoheshin nga shtëpitë e tyre për arsye të mbajtjes së bagëtive etj.



# PERIUDHA PAS TËRMET

## 3. Proçesi i vlerësimit.

Grupet e inxhinjereve të bashkive , të Institutit të Ndërtimit dhe inxhinjerë të huaj nga vënde mike kanë bërë një punë të mirë në vlerësimin e pallateve dhe ndërtesave individuale për të përcaktuar nga ana teknike dëmet e tyre dhe vlerësimin DS1-DS5.

Ky proçes nga të tre bashkitë ka vazhduar normalisht pamvarësisht ngadalsimit të periudhës së mbylljes nga pandemia, por që gjithsesi duke parë numrin e shumë të aplikimeve dhe përpunimin e dosjeve është bërë e mundur shpërndarja e granteve sipas DS-ve në familjet e dëmtuara nga tërmeti.




# PERIUDHA PAS TËRMET

## 3. Proçesi i vlerësimit.

Grupet e inxhinjereve të bashkive , të Institutit të Ndërtimit dhe inxhinjerë të huaj nga vënde mike kanë bërë një punë të mirë në vlerësimin e pallateve dhe ndërtesave individuale për të përcaktuar nga ana teknike dëmet e tyre dhe vlerësimin DS1-DS5.

Ky proçes nga të tre bashkitë ka vazhduar normalisht pamvarësisht ngadalsimit të periudhës së mbylljes nga pandemia, por që gjithsesi duke parë numrin e shumtë të aplikimeve dhe përpunimin e dosjeve është bërë e mundur shpërndarja e granteve sipas DS-ve në familjet e dëmtuara nga



# PERIUDHA PAS TËRMET

## 5. Ndjekja e skemës së bonusit të qirasë.

Në b/p me bashkitë këshillillat e bashkive u bë e mundur që të gjitha familjet në fillim në qytet pastaj në fshatra të marrin bonusin e qirasë. Janë dhënë gjithsej sipas bashkive bonus qiraje : **Bashkia Durrës 4903 familje, Bashkia Krujë 1771 familje, dhe bashkia Shijak 914 familje.**

Kjo bëri që shumë familje të akomodohen në banesa të ndryshme për të filluar një jetë normale, kështu mund të themi që dhe për zonat rurale është bërë e mundur që një pjesë e mirë e familjeve në çadra të marrin bonusin e qirasë dhe të akomodohen normalisht duke braktisur çadrat.

## 6. Ruajtja dhe prishja e objekteve me DS-5.

Gjatë vitit 2020 në të gjithë qarkun janë demoluar

Bashkia Durrës: 39 pallate dhe 473 banesa individuale.

Bashkia Shijak: 29 pallate dhe 566 banesa individuale.

Bashkia Krujë: 20 pallate dhe 6 banesa të ndryshme.

Për ruajtjen e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i nëntorit të 2019 ka dhënë drejtoria vendore e policisë së qarkut me strukturat e saj.





# PERIUDHA PAS TËRMET

## 7. Miratimi i lejeve të përshpejtuara për riparimin e objekteve të dëmtuara

### **Bashkia Durrës.**

Pranë DPKZHT në bashkinë Durrës janë paraqitur nëpërmjet platformës elektronike të e-lejeve , në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 796, datë 11.12.2019 “Për disa ndryshime të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar”, kërkesa për pajisje me leje ndërtimi për riparime, restaurime me procedurë të përshpejtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.

Gjithsej deri në atë periudhë janë miratuar **24 leje të përshpejtuara** për riparimin e objekteve si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.


Riparimi i tyre sjell përdorimin e **889 apartamenteve**.

Ka edhe **5 miratime për riparime leje objektsh sherbimi** (hotel, reparti mekanik, institucion QKF, call center).

Nga njësitë administrative janë konfirmuar gjithsej **141 leje për riparime të nivelit DS1**, të ardhura kryesisht nga individë për riparimin e banesave apo njësive individuale

**Bashkia Shijak: 5 leje të të përshpejtuara**

**Bashkia Krujë : 181 leje të përshpejtuara**



## PERIUDHA PAS TËRMET

### **Më pas këto leje u ndërprejnë sepse filloi rindërtimi dhe vazhdimi i bonusit të qirasë.**

Në të njëjtën kohë është ndjekur dhe monitoruar edhe procesi i dhënies së lejeve të ndërtimit nga Njësitë Administrative si dhe nga Urbanistika e bashkisë në lidhje me ndërtimet, si dhe ndërhyrjet që qytetarët apo investitorët e pallatëve kanë kërkuar që ti bëjnë riparimet vet në mënyrë individuale konform të gjitha procedurave ligjore.

### **8. Aplikimet e qytetarëve për banesat e dëmtuara sipas DS-ve .**

**Bashkia Durrës:** 20798 nga të cilat 5728 janë bërë në dhjetor 2020.

**Bashkia Krujë :** 4576 familje , nga të cilat 291 janë bërë në dhjetor 2020.

**Bashkia Shijak:** 3022 familje, nga të cilat 331 janë bërë në dhjetor 2020.

Gjatë vitit 2020 aplikimet janë hapur tri herë për ti ardhur në ndihmë qytetarëve për të aplikuar dhe të mos mbetet asnjë familje e dëmtuar nga tërmeti pa aplikim.

### **9. Miratimi i të gjitha vendimeve të Këshillave Bashkiakë në një kohë të shkurtër për procesin e Rindërtimit.**

Gjatë gjithë vitit 2020 këshillat bashkiakë kanë marrë vendime të shumta për procesin e rindërtimit, të cilat nga institucioni i Prefektit është bërë e mundur kontrolli dhe vlerësimi i tyre nga ana ligjore në një kohë rekord dhe të shpejtë me qëllim që të mos kishte asnjë vonesë nga ana jonë, si dhe procesi të vazhdonte me ritme të shpejta, në ndihmë të dëmtuarve nga tërmeti.

# RINDËRTIMI

PREFEKATURA E QARKUT DURRES

## 10. Rindërtimi i banesave individuale. (Tabela)

**TABELA PER BANESAT E DEMTUARA NGA TERMETI I NENTORIT 2019 Që PO RINDËRTOHEN  
30.12.2020**

Nr.	Emertimi	Nr. Banesave total	Nr Banesave te demoluara	Nr Banesave ne plate	Nr Banesave ne mure	Nr Banesave ne çati	Nr. Banesave te perfunduar a
<b>I.</b>	<b>BASHKIA DURRES</b>						
1	Njes. Admin. Manez	132	132	61	21	5	0
2	Njes. Admin. Ishem	274	181	70	37	0	0
3	Njes. Admin. Sukth	88	37	4	20	10	0
4	Njes. Admin. Rrashbull	33	4	0	4	1	1
5	Njes. Admin. Katundi Ri	52	32	14	5	0	0
	Shuma Njesite e Fshatrave	579	386	149	87	16	1
1	Njes. Admin. Rajoni 1	0					
2	Njes. Admin. Rajoni 2						
3	Njes. Admin. Rajoni 3						
4	Njes. Admin. Rajoni 4	60	47	5	7	0	0
5	Njes. Admin. Rajoni 5	8	4	2	2	0	0
6	Njes. Admin. Rajoni 6	48	36	23	21	10	0
	Shuma Rajonet e qytetit	116	87	30	30	10	0

# RINDËRTIMI

II.	BASHKIA SHIJAK							
1	Njesia Admi. Shijak	147	51	30	25	19	0	74
2	Njesia Admi. Maminas	151	117	114	117	80	35	29
3	Njesia Admi. Gjepalaj	138	122	112	85	44	31	8
4	Njesia Admi. Xhafzotaj	144	115	109	108	70	28	19
	TOTAL BASHKIA SHIJAK	580	405	365	335	213	94	130

# RINDËRTIMI

## 11. Rindërtimi i shesheve të rindërtimit në të tre bashkitë.

**Bashkia Durrës:** është në proces të studimit të planit për rindërtimin me firmën e Emirateve për 2000 apartamente. Kanë filluar ndërtimi i dy pallateve në qytetin e Durrësit.

**Bashkia Shijak:** sheshi është gati nga infrastruktura dhe ka filluar ndërtimi për 9 pallate

**Bashkia Krujë** në komunikim të vazhdueshëm me AKPT dhe Ministrinë e rindërtimit, ka miratuar 4 plane të detyruara vendore përkatësisht për shtet e rindërtimit në Thumanë, Bubq, Fushë Krujë dhe Krujë dhe për zonat e tjera do të përdoret metoda e pikëzimit e cila është në proces nga AKPT.

Në sitin e ndërtimit në Thumanë, Bubq dhe Fushë Krujë vijon puna për ndërtimin e infrastrukturës si dhe ka filluar ndërtimi i banesave individuale në të tre shtet e Thumanës Bubqit dhe Fushë Krujës.



# PËRURIMI

## 12. Proçesi i riparimit të ndërtesave me DS1-DS3 për ambientet e përbashkëta.

**Bashkia Durrës:** do të riparohen ambiente të përbashkëta për 615 pallate dhe deri tani kanë përfunduar 216 pallate.

**Bashkia Shijak:** do të riparohen ambiente të përbashkëta për 27 pallate dhe deri tani kanë përfunduar 24 pallate.

**Bashkia Krujë :** në pritje të fondit për riparim.


## 13. Përrurimi i shkollave të rindërtuara.

Me përparësi gjatë periudhës së tremujorit të fundit të vitit 2020 institucioni i prefektit ka ndjekur monitoruar përrurimin e shkollave dhe banesave individuale.



# OPERACIONET KUNDËR ZJARREVE

Stacionet e MZSH të qarkut Durrës, duke qenë gjithmonë një sektor kyç në mbrojtje të jetës, pronës dhe sigurisë së komunitetit, në vlerësim të të gjithë punës së shërbimit, shpreh fjalët më të mira për kontributin, sakrificat dhe përkushtimin e gjithë efektivit në përballje me fatkeqësitë aq të mëdha natyrore si ato të tërmeteve, si dhe ato të natyrave të ndryshme, duke gjykuar që gjithë rezultati i këtyre situatave janë fryt i organizimit të punës së drejtuesve të stacioneve dhe bashkive, i zbatimit të detyrave të shtabit të emergjencave të Prefekturës, punës të sektorëve por dhe i shpirtit luftarak, disiplinës, profesionalizmit, dinjitetit, përkushtimit deri në vetmohim dhe ndershmerisë së efektivit në përmbushje të misionit.



# OPERACIONET KUNDËR ZJARREVE

Duke sjellë edhe një herë në vëmendje punën dhe seriozitetin, disiplinën dhe përkushtimin e treguar nga efektivitë zjarrfikës, duke ju përgjigjur organizimit të punës në funksion të situatave, për mobilizimin në një kohë rekord të detyrës, duke evindentuar në kohë shqetësimet e qytetarëve nga zyra e informacionit rast pas rast, duke gjetur gjuhën e përshtatëshme me ta, përcjelljen e detyrave për grupet sipas rëndësisë së situatave, sqarimin dhe vlerësimin e tyre nga komandatët e shërbimit, raportimin në kohë për detyrat e marra, efikasitetin dhe efektivitetin e të gjitha ndërhyrjeve me automjete zjarrfikëse, autoskallë, mjete të thjeshta dhe rrethimore si repart gadishmërisë së përhershme, këto efektiva kanë bërë të mundur fikjet e vatrave të zjarrit dhe ndërhyrjet operationale të tjera që shikohen qartë në tabelën e mëposhtme.





# OPERACIONET KUNDËR ZJARREVE

## PASQYRA E NDËRHJRJEVE OPERACIONALE PËR STRUKTURAT E MZSH-së Qarku Durrës

NR.	NDËRHJRJET OPERACIONALE	Janar Dhjetor 2020			
		MZSH Durrës	MZSH Kruje	MZSH Shijak	Total Qarku
1	Objekte Civile(banimi)	78	41	34	153
2	Objekte,aktivitete shërbimi (dyqane,salla,magazina etj.)	27	8	2	37
3	Objekte akomoduese turistike	0	0	0	0
4	Objekte Didaktike (shkolla, kopshte, çerdhe)	0	0	0	0
5	Objekte ku ushtrohet aktivitet tregetimi me lëndë lehtesisht të djegshme	4	1	1	6
6	Objekte administrative	0	0	0	0
7	Objekte me rrezik te shtuar(uzina,fabrika të perpunimit te lëndëve djegëse)	5	2	14	21
8	Mjete transporti	48	10	6	64
9	Kullota, pyje, shkurre, barishte, mbeturina.	510	173	167	850
10	Ndërhyrje për shpëtimi	75	35	25	135
11	Alarme falsë	2	0	0	2
12	Nuk ka qënë e nevojshme ndërhyrja	3	0	0	3
13	Te tjera Thithje uji Nderhyrje me IKMT	84	38	48	170
	<b>Totali</b>	836	308	297	1441

# KANALET KULLUES DHE TË UJITJES

## Punimet e Shërbimit të Rrjetit Ujor. ( Kanalet kullues dhe të ujitjes)

Institucioni i Prefektit me përparësi ka ndjekur planizimin dhe zbatimin e Punimeve të Shërbimit të rrjetit Ujor ( pastrimit të kanaleve të para nga ndërmarja e Ujitjes dhe Kullimit dhe pastrimin e kanaleve të dyta dhe të treta nga bashkitë, si dhe ndjekjen e inspektimeve në rezervuarët e qarkut).

Objekte te mirembajtjes ne kullim (kanale kullues, KUL, argjinatura etj)	Vlera per vitin 2020 (ne leke)	PREVENTIVA	Statusi aktual projektit te zbatimit: Me projekt zbatimi	Bashkia	m3 dhera te larguar	km te pastruar/ sistemuar	ha qe i permiresohen treguesit e kullimit
<b>KULLIM</b>	7,617,609	8,621,295	0	0	108,870	10	4,830
<b>Kanali Kullues K.K.14 Bilaj-Fushe Kruje</b>	1,026,031	1,026,032	me projekt	Kruje	13,798	4.2	380
<b>Kanali K.Ujrave Larta TONA</b>	3,095,778	3,347,098	me projekt	Durres	45,132	3.2	2,250
<b>Kanali K.Ujrave Larta Topona</b>	1,484,350	1,679,435	me projekt	Durres	21,205	1.5	1,300
<b>Kanali K.Ujrave Larta Perroi Tarin</b>	2,011,450	2,568,730	me projekt	Durres	28,735	1.1	900

## KANALET KULLUES DHE TË UJITJES

Objekte te mirembajtjes ne ujite	Vlera per vitin 2020 (ne leke)	PREVENTIVA	Statusi aktual projektit te zbatimit: Me projekt zbatimi	Bashkia perfitues e	m3 dhera te larguar	km te pastruar/ mirembajtur	ha qe i permiresohet ujitja nga mirembajtja
<b>UJITJE</b>	1,981,752	1,803,578			18,589	6	37
<b>Kanali Ujites Ndroq Çallik</b>	1,981,752	1,803,578	me projekt	Durres, Shijak	18,589	6	37
<b>TOTALI</b>	9,599,361	10,424,873	-	-	127,459	16	4,867

# KANALET KULLUES DHE TË UJITJES

Bashkia Durrës (ndërmarrja “Rruga”) sipas tabelës së mëposhtme.

Nr	Njësitë Administrative dhe Rajonet	Pastrim kanali në ml
1.	Shkozet	365
2.	Spitallë	1530
3.	Sukth	10650
4.	Manëz	14450
5.	Ishëm	350
6.	Rrashbull	6700
7.	Plazh	940
8.	Shumatorja	34985

Për rezervuarët bashkia Durrës ka hedhur në tenderim dhe është në procesin e marrjes së lejes së ndërtimit për dy rezervuarë, Arapaj nr-1 dhe Spitalnr-1, për riparimet e shkarkuesve katastrofik.

Bashkia Shijak sipas tabelës së mëposhtme.

Nr	Njësitë Administrative dhe Rajonet	Pastrim kanali në ml
1.	Maminas	2382
2.	Gjepalaj	1500
3.	Xhafzotaj	3468
4.	Shumatorja	7350

# TASK –FORCA VENDORE ANTIKANABIS

## Task Forca Vendore Antikanabis

Gjatë periudhës **JANAR –DHJETOR 2020**, në territorin e Qarkut Durrës dinamika e kriminalitetit me tendencë kultivimin e bimëve narkotike paraqitet si më poshtë:

**Janë evidentuar 116 raste** të kultivimit të bimeve narkotike gjatë kontrollit të ushtruar në Njësite Administrative Nikël, Cudhi, Fushë Krujë, Ishëm, Xhafzotaj, Shijak, Bubq, Durrës dhe Manëz në fshatrat Fushë Krujë, Kuraten, Zgërdhesh, Larushk, Zallë, Kurcaj, Sallmone, Shqezë, Bruz Mal, Barkanesh, Droje Mukje Rranxë Mafsheq, Brret, Boville, Rinas, Shetaj, Bizë, Shkafane, Lalëz, Likmetaj, Larushk, Drrac, Kroj madh, Cudhi Kamp, Noj, Kameronas, Zezë, Borianë, Zallë, Virjon, Arameras, Zezë, Borianë, Bruz Zallë, Mazhë e Vogël, Cudhi Kant, Picrrage, Bilaj Bubq, Vadardhë, Bura, Halilaj, Bruz- Mal, Virjon dhe Arameras dhe Kodër Laç, Thumanë, Borizane, Noje, Mallkuç, Rrotull, Grizë, Kurcaj, Derven, Picërragë, Dukagjin i Ri, lagjja Boje, Shkozë e Bardhë dhe Luz zbuluar 30, ose 25.86 %.

**Janë proceduar penalisht 46 autorë, nga të cilët 22 janë arrestuar, 1 ndaluar, 12 ndiqen në gjendje të lirë dhe 11 janë shpallur në kërkim.**



## TASK –FORCA VENDORE ANTIKANABIS

Gjithashtu, janë **referuar materialet për 33 persona** me detyrë Inspektorë të Emergjencave Civile Bashkia Durrës, Ishëm, Drejtor i Axhensisë së zonave të mbrojtura pyjore, përgjegjës i sektorit pyjor Bashkia Krujë, administrator i Njesisë Administrative Nikël, Kryeplak i zonës, kryepleq të fshatrave dhe Kryetar i Këshillit të Pleqërisë së fshatit Vardardhë, roje mjedisore në A.D.Z.M.Durrës, 2 Kryepleq në fshatrat Rrënzë dhe Kroji, Madh, dhe roje mjedisore në bashkinë Krujë, Kryetar i Njesisë Administrative Cudhi dhe kryepleq të fshatrave, Bizë, Shkretë, Cudhi Qendër, Cudhi Kant, Bruz Zall, Bruz Mal, dhe Kroi i Madh për veprën penale “Shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 I K.penal për veprën penale “Shpërdorim detyre”, “Moskallëzim krimi” dhe “Kultivim i bimeve narkotike” parashikuar nga nenet 248, 300 dhe 284 të K. Penal, nga të cilët arrestuar **4**, ndaluar **0**, ndjekur në gjendje të lire **29** shpallur në kërkim **0**.

**Janë gjetur/asgjësuar 1656 ambjente nga të cilat 1641 janë ambjente publike dhe 15 janë ambjente private me 57218 bimë narkotike**, nga të cilat **56303 bime** janë të mbjella në tokë, **915 fidanë/kubikë** dhe **0** degë në proces tharje.

Janë organizuar 5 takime të Task Forcës Antikanabis, në të cilat Prefekti ka theksuar se duhet rritur bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit sidomos nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.



## TASK –FORCA VENDORE ANTIKANABIS

Janë zhvilluar takime sensibilizuese nga Prefekti i Qarkut Durrës:

**Datë 13.05.2020** në zbatim të planit kombëtar antikanabis Prefekti së bashku me nëndrejtorin e DVP me stafin e tij, drejtori i Sektorit të Bujqësisë në bashkinë Durrës, përfaqësues i SEB, Kryetari i Njesisë Administrative Ishëm, Kryepletë e fshatrave të Njesisë Administrative Ishëm zhvilloi një takim sensibilizimi si dhe u vu theksi tek bashkëpunimi me policinë, informi mi për zbatimin e detyrës dhe në mënyrë të veçantë kontrolli i terrenit me grupe të përbera nga njësia, bashkia dhe policia. Në përfundim të takimit u bë një kontrolli i një zone me dron. Ky takim u bë duke qënë sërë kjo zonë është një nga zonat me risk.

**Datë 18.05.2020** Takim me Seksionin e Ekstensionit Bujqësor për nxitje të fermerëve drejt kulturave bujqësore fruta dhe perime.

**Datë 19.05.2020** takim me nëndrejtorin e DVP për problemin e zonave me risk, intensifikim kontrollesh dhe bashkëpunim me Njësitë Administrative në Qark, si dhe iu dorëzua shkresa e zonave me risk të qarkut.

**Datë 19.05.2020** takim me Seksionin e Policisë Ushtarake u theksua ushtrimi i kontrollit në të gjithë territorit që mbulon ky seksion.

**Datë 18.05.2020** takim me Kryetaren e Bashkisë Durrës dhe Njësitë Administrative iu është tërhequr vëmendje për bashkëpunim dhe zbatim të detyrave sipas ligjit.

Gjithashtu Prefekti ka caktuar të gjitha zonat me risk të lartë në qarkun Durrës dhe ia ka përcjellë këtë informacion Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.

**Më datë 05.05.2020 dhe 28.05.2020** janë zhvilluar takimet e radhës së Task Forcës Vendore Antikanabis, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të task forcës. Nga ana e Prefektit dhe drejtorit të Policisë Vendore të Qarkut u theksua dhe një herë bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve.

## TASK –FORCA VENDORE ANTIKANABIS

Gjithashtu me kërkesë të Bashkisë Durrës më datë 21.06.2020 u organizua kontroll në terren në Njësitë Administrative Sukth, Ishëm dhe Manëz në bashkëpunim me Prefektin e Qarkut, DVP, Policinë Bashkiake etj. Në këtë kontroll u bë e mundur zbulimi i katër parcelave me lende narkotike.





# KOMITETI RAJONAL ANTITRAFIK

Të gjitha sfidat në fushën e trafikimit dhe hapat e hedhura në këtë drejtim kanë pasur dhe do të kenë mbështetjen e vazhdueshme të Institucionit të Prefektit i cili koordinon punën në nivel rajonal, dhe ka vendosur si një nga prioritetet e tij adresimin e të gjithë problematikave për zgjidhjen minimizimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Në fillim të vitit 2020 janë përcaktuar objektivat dhe miratuar plani i veprimit për këtë vit. **Janë zhvilluar gjithësej 11 takime dhe 1 konkurs.** Të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Komitetit Rajonal Antitrafik janë raportuar në mënyrë sistematike pranë Koordinatorit Kombëtar Antitrafik.



# MARËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

## Konfirmimi i Gen-Planeve

Gjatë vitit 2020 janë trajtuar 3 praktika shkresore për konfirmim Gen-Plani si më poshtë:

Konfirmim Gen-Plani të objektit "Ish Reparti Ushtarak 9010/5" me vendndodhje në Rrashbull Durrës

Gen-Plani të objektit "Klub stabilimenti (godinë restorant dy kate, stabiliment Durrës)" me vendndodhje në Sektorin "Iliria", Plazh, Durrës

Gen-Planit të Objektivit "Magazinë 2 katëshë" me vendndodhje në Shkozet - Konfirmuar



# FUNKSIONET E DELEGUARA

## Gjëndja Civile:

- ▶ Në zbatim të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” zyra e arkivit të gjendjes civile ka lëshuar çertifikata të shërbimit të gjendjes civile, duke plotësuar kërkesat e shtetasve për akte trashëgimie 2840, për sigurime shoqërore dhe shëndetsore 302, për jashtë shtetit e për bashkim familjar 987, për arsye të ndryshme 184, për efekte gjyqësore 73, për dëmshpërbim për të persekutuariat politik 89, për fitim shtetësie 4.
- ▶ Në mbështetje të Ligjit Nr.130/2013 janë lëshuar çertifikata për efekt korrigjimi të gabimeve materiale, për ndreqjen e të dhënave në rregjistrat e zyrave të gjendjes civile pranë njësive administrative përkatëse (1141), si dhe fotokopjet e fletëve të rregjistrave përkatës.



# FUNKSIONET E DELEGUARA

## Legalizimi i dokumentave:

- ▶ Bazuar në VKM Nr.134 datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja për përdorim brenda vendit” **janë legalizuar 33250 dokumenta** të lëshuara nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.



# FUNKSIONET E DELEGUARA

## Shqyrtimi i kundravajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor

- ▶ Në lidhje me kundravajtjet administrative, në zbatim të Udhëzimit Nr.687 datë 05.12.2013 “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimi i gjobave në fushën e qarkullimit rrugor” janë shqyrtuar **248 praktika shkresore të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, ndër këto 14 për alkool, 4 nuk i ndaluan policisë, 1 parakalim në kthesë, 4 kalim në sens të kundërt, 225 tejkalim shpejtësie.**



# VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

- ▶ Institucioni i Prefektit ka kryer verifikimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore si edhe përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm duke u shprehur për ligjshmërinë e këtyre Akteve, brenda afateve kohore (10 ditore) të përcaktuara qartë në Ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.
- ▶ Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, janë verifikuar 397 akte të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (Këshilli i Qarkut Durrës, Bashkia Durrës, Bashkia Krujë, Bashkia Shijak), nga të cilat:
  - ▶ - **393 janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore.**
  - ▶ - **4 nuk janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore**

# VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

## ▶ Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve

- ▶ Në mbështetje të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, në vitin 2020 është bërë verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative si më poshtë vijon:
- ▶ Më datë 15.01.2020 u bë verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative të bashkisë Krujë për vitin 2019. Në total gjatë kësaj periudhe nga këshilli bashkiak Krujë janë miratuar 106 vendime të cilat që të gjitha janë depozituar pranë institucionit të Prefektit.
- ▶ Më datë 20.02.2020 u bë verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative të bashkisë Durrës për periudhën Qershor-Dhjetor 2019. Në total gjatë kësaj periudhe nga këshilli bashkiak Krujë janë miratuar 39 vendime të cilat që të gjitha janë depozituar pranë institucionit të Prefektit.
- ▶ Më datë 24.09.2019 u bë verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative të bashkisë Durrës për periudhën Qershor – Dhjetor 2019. Nga verifikimi i kryer rezultoi se gjatë kësaj periudhe janë marrë 47 VKB të cilat janë depozituar pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Durrës.
- ▶ Më datë 15.10.2020 u bë verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative të bashkisë Durrës për periudhën Janar-Qershor 2020. Nga verifikimi i kryer rezultoi se gjatë kësaj periudhe janë marrë 63 VKB të cilat janë depozituar pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Durrës.

# VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Verifikimi i Ligjshmërisë së Akteve të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore						Dërguar në Gjykatë
Nr.	Njësi të vetëqeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti	Të bazuara në ligj	Të pabazuar a në ligj	Të rishqyrtuara nga Nj.Q.V	
		Prog.	Prog	Prog.	Prog.	Prog.
1	Këshilli i Qarkut Durrës	17	17	0	0	0
2	Bashkia Durrës	133	133	0	0	0
3	Bashkia Krujë	128	125	3		
4	Bashkia Shijak	119	118	1	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>397</b>	<b>393</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>




# FINANCA DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

## PREFEKURA VITI 2020 SHPENZIME TE REALIZUARA

Nr	Emertimi	PLANIFIKUARA	FAKT	%
	<b>SHPENZIME BUXHETORE TOTAL</b>	28,004,000	25,091,735	90
1	<b>PAGA PERSONELI</b>	18,600,000	17,928,282	96.39
2	<b>KONTRIBUTE PER SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE</b>	3,790,000	2,909,263	76.76
3	<b>MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA</b>	5,505,000	4,195,190	76.21
4	<b>TRANSFERTA PER BUXHETE FAMILJARE E INDIVIDE</b>	109,000	59,000	54.13
5	<b>INVESTIME</b>	0	0	

# FINANCA DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE



# FINANCA DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

- Siç shihet nga tabela dhe nga grafikët buxheti u realizua në masën 90 % dhe zërat kryesorë të tij : Pagat me 96.39 %, Sig. Shoq. e Shëndetësore 76.76%, Mallra e shërbime të tjera 76.21%. Mosrealizimi i zërit në Mallra e Shërbime u ndikua nga pezullimi i fondeve gjatë periudhës së Pandemisë nga ana e Qeverisë si dhe nga realizimi i çmimeve më të ulta gjatë prokurimeve elektronike.
- Është bërë shpallja e vendeve vakante të punonjësve me status nënpunësi (gjithsej 6 vende), hedhja e të dhënave në sistemin HRMIS sipas kriterëve të kërkuara në zbatim të Ligjit 152/2013 "Për statusin e nënpunësit civil". Pas shpalljes së vendeve vakante, gjatë kësaj periudhe janë pranuar në shërbimin civil në Prefekturë 4 specialiste të lartë, 2 në Sektorin e Zhvillimit Urban dhe 2 në Sektorin e Emergjencave Civile. U plotësua dhe vendi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe ai i Përgjegjës të Sektorit të Financës. Ngelen dhe 2 vende të tjerë vakante, 1 në sektorin Juridik dhe 1 në sektorin e Financës.
- Është bërë hedhja e të dhënave të dosjeve individuale në këtë sistem dhe po punohet akoma për pasqyrimin e përvijës së punës duke ndjekur trajnime periodik.
- U krye raportimi vjetor i nevojave për rekrutim në Ministrinë e Brendshme, si dhe gjendja mbi zbatimin e Ligjit 152/2013 "Për statusin e nënpunësit civil" tek Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil.

# FINANCA DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

- Siç shihet nga tabela dhe nga grafikët buxheti u realizua në masën 90 % dhe zërat kryesorë të tij : Pagat me 96.39 %, Sig. Shoq. e Shëndetësore 76.76%, Mallra e shërbime të tjera 76.21%. Mosrealizimi i zërit në Mallra e Shërbime u ndikua nga pezullimi i fondeve gjatë periudhës së Pandemisë nga ana e Qeverisë si dhe nga realizimi i çmimeve më të ulta gjatë prokurimeve elektronike.
- Është bërë shpallja e vendeve vakante të punonjësve me status nëpunësi (gjithsej 6 vende), hedhja e të dhënave në sistemin HRMIS sipas kriterëve të kërkuara në zbatim të Ligjit 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil". Pas shpalljes së vendeve vakante, gjatë kësaj periudhe janë pranuar në shërbimin civil në Prefekturë 4 specialiste të lartë, 2 në Sektorin e Zhvillimit Urban dhe 2 në Sektorin e Emergjencave Civile. U plotësua dhe vendi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe ai i Përgjegjësit të Sektorit të Financës. Ngelen dhe 2 vende të tjerë vakante, 1 në sektorin Juridik dhe 1 në sektorin e Financës.
- Është bërë hedhja e të dhënave të dosjeve individuale në këtë sistem dhe po punohet akoma për pasqyrimin e përvijës së punës duke ndjekur trajnime periodik.
- U krye raportimi vjetor i nevojave për rekrutim në Ministrinë e Brendshme zbatimin e Ligjit 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil" tek Komisionin Shërbimit Civil.



# PRIORITETET E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT DURRËS PËR VITIN 2021

- ▶ **1.RESPEKTIMI I KUADRIT LIGJOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT QEVERTAR NË SIGURINË PUBLIKE, SHËNDETËSI,TURIZËM, PUNËSIM, BUQËSI, MBROJTJEN E MJEDISIT DHE SHËRBIM ZJARRFIKËS.**
- ▶ **2. RITJA E PËRGJEGJËSISË DHE ANGAZHIMI I STRUKTURAVE PËRKATËSE NË PLANIFIKIMIN DHE MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E SITUATAVE TË MUNDËSHME EMERGJENTE DHE KRIZAVE NË QARK GJATË VITIT 2021.**
- ▶ **3. NDJEKJA E SITUATËS ANTI COVID-19, PASTËRMET (RINDËRTIMI) GJATË VITIT 2021DHE NDJEKJA E MASAVE PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË QEVERISË.**
- ▶ **4. VERIFIKIMI I LIGJISHMËRISË SË AKTEVE ME KARAKTER NORMATIV TË ORGANEVE TË NJËSIVE TË VETQEVERISJES VENDORE DHE ZBATIMI I LIGJISHMËRIS NË VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT.**
- ▶ **5.SHQYRTIMI I ANKESAVE DHE KËRKESAVE TË QYTETARËVE DUKE I ADRESUAR DREJT ZGJIDHJES LIGJORE.**
- ▶ **6. RITJA E PËRFORMANCËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË NIVEL QARKU.**



**FALEMINDERIT!**